

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR I
SHOQËRISË “SBI&PARTNERS” SH.P.K**

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “SBI&PARTNERS” sh.p.k është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014, si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar me Ligjin Nr.9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr.92/2012, datë 27.09.2012 dhe me Ligjin Nr.8/2015, datë 19.02.2015 dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K)

Në këtë Statut:

- Ligji është Ligji Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014;
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;
- QKB- Qendra Kombëtare e Regjistrimit në Shqipëri.

Sot, më 27/06/2018, une themeluesi;

- Suad Idrizi , i biri i Beqir-it , i datëlindjes 05.02.1988, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë , ne adresen Njesi Administrative Nr.7, Rr.Frosina Plaku,Kompleksi Magnet, Pall.Antlia, Ap.153,i pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.028907287/I80205090S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e ortakut të vetem te shoqërisë “SBI&PARTNERS” sh.p.k.

Neni 1

Emri dhe Forma Juridike

- 1.1 Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërisë është “SBI&PARTNERS” SH.P.K.
- 1.2 Shoqëria “SBI&PARTNERS” SH.P.K. është një person juridik privat, themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (me pas referuar si “Ligji”) në formën e shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.3 Shoqëria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- 2.1 Ne Fushen e Jurisprudences (Drejtësisë).
- 2.2 Kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar dhe te njohur nga ligji nr.9109, date 07.07.2003 “ Per Profesionin e Avokatit ne RSH, i ndryshuar;
- 2.3 Sherbime Ligjore;
- 2.4 Mbrojtje ligjore dhe Perfaqesime Ligjore prane Instirucioneve Shqiptare dhe Te Huaja;



- 2.5 Ndhime dhe Konsulence Juridike Nepermjet Keshilimit Ligjore Per Ceshtje Te Ndryshme, Per Personat Fizik apo Juridik, Publik apo Private, te Institucioneve Publike apo Private, ne lidhje me cdo problem eventual;
- 2.6 Asistence Juridike;
- 2.7 Perpilim Aktesh Juridike;
- 2.8 Zgjidhjen e Ceshtjeve me Marreveshje mes paleve, etj.

Neni 3 **Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat te pacaktuar kohor.

Neni 4 **Selia, Adresa**

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, Blv."Gjergj Fishta", Rr."Astrit S.Balluku, Pall Edil-Al. Nr.3, D.5, Zyra Nr.6.
- 4.2 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është www._____.
- 4.3 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon lawfirmidrizi@yahoo.com Cel:+ 355 69 75 666 96;
- 4.4 Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 5 **Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakut te vetem.**

- 5.1 Në rast vdekje apo falimenti, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut te vetem.
- 5.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të ortakut te vetem mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Kreu II **Kapitali i Regjistruar**

Neni 6 **Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (njeqind) Lekë.
- 6.2 Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetem i shoqerise. Shoqeria mund te shtojte ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Ortakut te vetem.
- 6.3 Kapitali fillestar i shoqerise "SBI&PARTNERS" SH.P.K eshte 100 (njqind) leke. Kapitali eshte 100 % i ortakut te vetem.
- 6.4 Kapitali per momentin eshte i pa ndare. Respektivisht Suad Idrizi zoteron nje kuote te barabarte me 100 (njeqind) leke.
- 6.5 Ortaku i vetem ka të drejtë te tjetërsojë këtë kapital, të shtojë apo të pakesojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.



6.6 Ortaku I vetem, miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoje statuti, per ndryshimin e mases se kapitalit themeltar dhe shdnerrimin e shoqerise ne nje forme tjetër, per punesimin e punonjesve dhe pagat, si dhe probleme te tjera te lidhura me punesimin ne zbatim te legjislacionit shqiptar etj. Vendimet e Ortakut te vetem evidentohen ne nje regjister.

Neni 7

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

7.1 Administratori mund ti kërkojë ortakut te vetem të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera (në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara.

7.2 Zotëruesi i kuotes do të jete përgjegjës dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 8

Certifikatat e kuotave

8.1 Ortaku i vetem ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

10.1 Ortaku I vetem, mund të zmadhojë dhe te vendos zvogelimin per kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e veta përcaktuar në vendimin përkatës.

Neni 11

Hetimet e posaçme

11.1 Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu III Administratori

Neni 12

Emërimi i Administratorit

- 12.1** Ortaku i vetem emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 12.2** Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 12.3** Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i shoqërise.
- 12.4** Administratori, Suad Idrizi do të caktohet si Kryetar i mbledhjeve të Administratorëve. Të dhënat e identifikimit dhe specimenët e nënshkrimit: Suad Idrizi , i biri i Beqir-it i datëlindjes 05.02.1988, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë , ne adresen Njesi Administrative Nr.7, Rr.Frosina Plaku, Kompleksi Magnet, Pall.Antlia, Ap.153,i pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.028907287/I80205090S.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- 13.1** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
 - përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatiti dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakut të vetem për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 13.2** Administratori thërret Ortakun e vetem, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë,
 - shoqëria propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë.
- 13.3** Nëse ortaku i vetem, emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Ortaku i vetem mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14

Shpërbërja dhe likuidimi

- 14.1** Shoqëria mbaron me vendim të Ortakut të Vetem ose kur ka një prishje të parakoheshme për arsye të parashikuara në ligj.

Neni 15



Viti Financiar

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 16 **Kontrolli Financiar**

- 16.1 Kontrolli financiar I Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 17 **Bilanci Vjetor**

- 17.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrative mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Ortaku I Vetem I Shoqërisë.
- 17.2 Shoqëria është e detyruar të dorëzojë bilancin brenda afatëve të caktuara në ligjin mbi kontabilitetin.

Neni 18 **Perfaqësimi**

- 18.1 Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
- 18.2 Administratori, që përfaqësonë shoqërinë tregtare, mund të autorizojë persona të tjerë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
- 18.3 Njoftimet e drejtuara secilit prej administrator janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
- 18.4 Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI **Prishja dhe njoftimet**

Neni 19 **Prishja dhe likuidimi**

- 19.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të ortakut të vetem;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - e) me vendim të gjykatës;
- 19.2 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.
- 19.3 Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 20

Njoftimet

- 20.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 20.2 Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërisë).

Neni 21 **Punesimet ne Shoqeri**

- 21.1 Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 22

- 22.1 Shoqeria merr persiper te derdh rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit.

Neni 23 **Gjuha**

- 23.1 Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 24 **Zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 24.1 Te gjithë mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

Neni 25 **Dispozita përfundimtare**

- 25.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut te Vetëm,

Suad Idrizi



Suad IDRIZI

Tiranë më 27/06/2018